



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS TË
KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, TË VULËS SË
KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË
KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE TË VULËS REZERVË TË
KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021

Referuar përcaktimeve të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ për administrimin e procesit zgjedhor, dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula rezervë për KQV-të.

Kodi Zgjedhor, në nenin 103, në paragrafin 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:
vula e KQV-së: “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit;
vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror;
vula rezervë: teksti është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”.

Formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së, dhe vulat rezervë për Komisionet e Qendrave të Votimit, referojnë përcaktimet Kodit Zgjedhor dhe VKM nr. 390, datë 6.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit, dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar. Ato prodhohen në sektorin e prodhimit të vulave zyrtare, pranë Ministrisë së Brendshme, me kosto 1800 (njëmijëetëqind) lekë.

Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit, dhe shpenzimet do të



përballohen nga buxheti i miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara Kodi Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Bashkëlidhur projektvendimit paraqiten:

- lidhja 1, formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së;
- lidhja 2, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 3, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 4, formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: __ Janar 2021

Nr: -----

PROJEKTVENDIM

PËR MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS TË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, TË VULËS SË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, DHE TË VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafët 1, shkronja “b”, dhe 2, nenin 103, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N:

Referuar nenit 19, paragrafi 1, gërma “n”, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Referuar neneve 20 dhe 21, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, nuk përcaktohet kompetencë për miratimin e formateve dhe specifikimeve të vulave që përdor administrata zgjedhore në përmbushje të detyrave të përcaktuara në ligj për organizmin dhe zhvillimin e zgjedhjeve.

Referuar përcaktimeve të nenit 99, të Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ për administrimin e procesit zgjedhor, dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së dhe vulat rezervë per KQV-në.

Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ, KQV, Kryetarit të KQV dhe vulës rezervë për KQVnë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021

Data: __ Dhjetor 2020

Nr: _____



Kodi Zgjedhor, në nenin 103, paragrafi 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:

vula e KQV-së: “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit;

vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror;

vula rezervë: teksti është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”.

Formatet e vulave që do të përdorë KZAZ-ja, KQV-ja, Kryetari i KQV-së, si edhe vula rezervë për KQV-në, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, materializojnë kërkesat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, si edhe kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafët 1, shkronja “b”, dhe 2, nenin 103, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Miratimin e formateve dhe specifikimeve të vulave që do të përdorë administrata zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, si më poshtë:
 - a) vula e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 1;
 - b) vula e Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes 2;
 - c) vula e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes 3;
 - ç) vula rezervë për Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes 4;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: __ Dhjetor 2020

Nr. ____

Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ, KQV, Kryetarit të KQV dhe vulës rezervë për KQVnë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021:

Formati i Vulës: KZAZ



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Numri i Identifikimit: KZAZ-NR-XX.
6. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021
Formati i Vulës: KQV



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit
7. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Formati i Vulës: Kryetari i KQV-së



Legjenda:

1. Gjatësia = 50 mm
2. Gjerësia = 25 mm
3. Stema e Republikës së Shqipërisë
4. tekst: Republika e Shqipërisë
5. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
6. KRYETARI
7. Numër serial pesëshifror: XXXXX
8. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të dates 25 Prill 2021

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

Formati i Vulës: KQV - REZERVË



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit; tekst: REZERVË
7. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021